



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Tiranë, më 19 Korrik 2018

PROJEKT REZOLUTË

PËR NJOHJEN DHE MBËSHTETJEN E VEPRIMTARISË SË MBROJTËSVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, NË PROMOVIMIN, NXITJEN DHE MBROJTEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE, FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE KONSOLIDIMIN E DEMOKRACISË

Ne, deputetët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

Duke riafirmuar rëndësinë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për konsolidimin e shtetit të së drejtës, demokracisë sociale dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut;

Duke riafirmuar rëndësinë e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Deklaratës së Kombeve të Bashkuara, datë 9 Dhjetor 1998, *“Mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve, grupeve dhe strukturave të shoqërisë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat universale të njeriut dhe liritë themelore*, Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Deklaratës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, datë 6 Shkurt 2008, *“Për mbrojtjen e të drejtave të mbrojtësve të të drejtave të njeriut”*, Rezolutat e Këshillit të Evropës 1660 (2009) dhe 1891 (2012) *“Mbi situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Evropës”* dhe Rezolutën 2095 (2016) së bashku me Rekomandimin 2085 (2016) *“Mbi forcimin e rolit dhe mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Evropës”*, Rezolutën 2225 (2018) dhe Rekomandimin 2133 (2018) *“Për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtarë të Këshillit të Evropës”*, Udhërrëfyesit e Bashkimit Europian dhe OSBE/ODHIR, dhe çdo akt tjetër ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, (në vijim referuar si *“aktet ndërkombëtarë për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut”*);

Duke konsideruar, mbrojtjen e të drejtave të individëve, organizatave ose grupeve shoqërore që luftojnë për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, një zhvillim të rëndësishëm, në forcimin e mëtejshëm të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në konsolidimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri;

Duke konsideruar promovimin dhe mbështetjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, hap të mëtejshëm në procesin e integritetit evropian të Shqipërisë;

Duke njohur dhe vlerësuar të drejtat dhe liritë e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për liri dhe siguri, të drejtën për procesin e rregullt ligjor, lirinë e shprehjes, të drejtën e organizimit dhe të drejtën e tubimeve paqësore;

Duke konsideruar përgjegjësitë dhe detyrimet e shtetit tone për të mbrojtur, promovuar dhe bërë efektive të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, nëpërmjet, marrjes së masave të nevojshme për konsolidimin e kushteve sociale, ekonomike dhe politike, si dhe garancitë juridike, në mënyrë që çdo individ në Republikën e Shqipërisë të mund, individualisht ose i organizuar me të tjerë, të gëzojë liritë themelore dhe të drejtat e njeriut;

Duke njohur dhe respektuar detyrimet e Republikës së Shqipërisë në promovimin dhe forcimin e vlerave demokratike në botë, në mbrojtjen e çdo mbrojtësi të të drejtave të njeriut, pa diskriminim dhe në mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë, nga dhuna, presionet ose represionet, kërcënimet, sulmet ose kanosjet nga çdo drejtim që vijnë, për shkak të veprimtarisë së tij/saj, në dobi të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke pranuar sfidat, me të cilat përballen mbrojtësit e të drejtave të njeriut duke mbrojtur të drejtat e grupeve të dobëta, veçanërisht të drejtat e grave, komunitetet e pakicave kombëtare dhe personave me orientim seksual të ndryshëm ose për shkak të identitetit gjinor të tyre (LGBTI) dhe/ose që i përkasin këtyre grupeve, të drejtat e refugjatëve, emigrantëve ose popullatave në lëvizje;

Duke konsideruar rreziqet për jetën dhe shëndetin, me të cilat, mund të përballen mbrojtësit e të drejtave të njeriut gjatë punës së tyre për hetimin dhe denoncimin e rasteve të korrupsionit të kryer nga zyrtarët publikë dhe funksionarët shtetërore ose për denoncimin e pandëshkueshmërisë së këtyre rasteve;

Duke shprehur mirënjohjen për të gjithë ata individë, në mbarë botën, të cilët kanë sakrifikuar jetën dhe shëndetin e tyre, për hir të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe denoncimin publik të rasteve të korrupsionit kryer nga zyrtarët shtetërore dhe funksionarët publikë;

Të ndërgjegjshëm se mbështetja dhe mbrojtja e mbrojtësve të të drejtave të njeriut është detyrë dhe përgjegjësi e shtetit;

VENDOSËM

1. Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut (nënkomisioni- *këtej e tutje*), të shërbejë si një mekanizëm për dialog midis Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
2. Nënkomisioni, në konsultim me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, të miratojë dhe të ndjekë zbatimin e Planit të Veprimit për promovimin dhe mbështetjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë, bazuar në standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtarë për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut;
3. Nënkomisioni, brenda 6 muajve nga miratimi i kësaj Rezolute, të paraqesë në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, raportin e detajuar mbi situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, së bashku me

rekomandimet përkatëse për nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtjesve të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

4. T'i kërkojmë qeverisë dhe/ose të ndërmarrë vet nisma/t ligjore për rishikimin e legjislacionit në fushë dhe përafrimin e tij me standartet ndërkombëtare me qëllim krijimin e një mjedisi mundësues për aktivitetet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut;
5. Të promovojmë nismat e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të distancohemi dhe të dënojmë çdo fushatë denigruese ose veprim kërcënues ndaj aktiviteteve të tyre;
6. Të zbatojmë mekanizmat e kontrollit parlamentar të parashikuara në rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë për të hetuar dhe nxjerrë konkluzione konkrete, duke propozuar dhe masat përkatëse mbi raste të denoncuar në Nënkomision nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut në lidhje me shkeljen e të drejtave të grupeve të dobëta, në veçanti: të drejtat e grave, të pjestarëve të pakicave kombëtare, komunitetit LGBTI, të drejtat e refugjatëve, emigrantëve ose popullatave në lëvizje, si dhe në lidhje me kërcënime që mund të hasin mbrojtësit e të drejtave të njeriut në luftën kundër korrupsionit kryer nga zyrtarët publikë dhe funksionarët shtetërorë ose për denoncimin e pandëshkueshmërisë së këtyre rasteve;
7. Të organizojmë një herë në vit, në bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet e pavarura dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri, takimin kombëtar lidhur me situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri.
8. T'i kërkojmë Këshillit të Ministrave, ngritjen e një strukture ndërministeriale me qëllim sigurimin e një mjedisi të sigurtë dhe të favorshëm për aktivitetin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.
9. T'i kërkojmë Këshillit të Ministrave të paraqesë raport vjetor në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vend. Në hartimin e raportit vjetor, të ftohen të kontribuojnë edhe autoritetet vendore dhe përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave në nivel vendor. Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe shoqëria civile të ftohen të kontribuojnë në diskutimin e raportit vjetor në një seancë të veçantë të Kuvendit të Shqipërisë;
10. T'i kërkojmë Këshillit të Ministrave të hartojë, në bashkëpunim dhe konsultim me shoqërinë civile, institucionet e pavarura dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri, një Strategji Kombëtare dhe Plan Veprimi Ndërministror për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut për:
 - a) përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional kombëtar, në lidhje me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, në përputhje me aktet ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të Njeriut;
 - b) për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në aktet ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut;
 - c) për promovimin e akteve ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut në nivel vendor dhe kombëtar;
 - d) për ngritjen dhe funksionimin e një mekanizmi kombëtar për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.
11. T'i kërkojmë strukturave përkatëse në Këshillin e Ministrave të cilat janë përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që të forcojnë bashkëpunimin me mbrojtësit e të drejtave të njeriut për denoncimin e rasteve të korrupsionit në sektorin publik.

12. T'i kërkojmë Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, të programojë dhe të realizojë formim të vazhdueshëm në lidhje me rolin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe forcimin e mirëqeverisjes, në përputhje me standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
13. T'i kërkojmë Këshillit të Ministrave të ndërmarë hapat e nevojshëm, në përputhje me aktet ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, për të zbatuar politika lehtësuese të regjimit të vizave dhe dhënien e vizave për qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, për ata mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët, janë subjekt i ngacmimeve, kërcënimeve, sulmeve dhe/ose persekutimeve si dhe atyre që përballen me një rrezik të menjëhershëm burgimi dhe keqtrajtimi në vendet e tyre si pasojë e aktivitetit të tyre në dobi të të drejtave të njeriut. Progresi dhe masat e ndërmara nga Këshilli i Ministrave në këtë drejtim të pasqyrohen në Raportin Vjetor mbi situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.
14. T'i kërkojmë Ministrisë për Europën dhe Punëve të Jashtme, të sigurojë një bashkëpunim të vazhdueshëm e të ngushtë me Përfaqësuesin Special të Kombeve të Bashkuara për situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe organizatat e tjera ndërkombëtare si Këshilli i Europës dhe OSBE/ODIHR, të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre, mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut;
15. T'i kërkojmë Këshillit të Ministrave, në mënyrë të veçantë, ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, të realizojë, në bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet e të drejtave të njeriut dhe organizatat ndërkombëtare të fushës, formimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë dhe shërbimeve të tjera, në të gjitha nivelet, lidhur me rolin dhe aktivitetin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Inkurajojmë ngritjen dhe funksionimin pranë Ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike të një zyre për të drejtat e njeriut dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut e ngarkuar të përfshijë qasje mbi të drejtat e njeriut;
16. T'i kërkojmë Qeverisë, në mënyrë të veçantë, ministrisë përgjegjëse për arsimin, sportin dhe rininë, në bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet e të drejtave të njeriut dhe organizatat ndërkombëtare të fushës, të marrë masat e nevojshme për përfshirjen në programet shkollore, parauniversitare të informacionit për rolin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, si dhe për përgatitjen dhe formimin profesional të mësuesve, në këtë fushë sipas modeleve më të mira;
17. Të ftojme organin e prokurorinë dhe sistemin gjyqësor të kontribuojnë, në mënyrë që mbrojtësit e të drejtave të njeriut, të gëzojnë akses në sistemin e drejtësisë dhe të mundësohen hetime të shpejta dhe të plota për rastet e dhunës, kërcënimeve dhe/ose ngacmimeve ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut;
18. Të ftojme mediat e pavarura, publike dhe jopublike, për të kontribuar, në krijimin e hapsirave për të promovuar punën dhe aktivitetin e mbrojtësve të të drejtave, në dobi të forcimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë;
19. Të ftojme Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

Drejtorinë e Ndihmës Juridike të bashkëpunojnë ngushtësisht me organet e qeverisjes vendore, përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave në nivel vendor, organet e zbatimit të ligjit, organizatat/rrjetet e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare të fushës, për të promovuar dhe mbrojtur mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe aktivitetin e tyre, në nivel vendor dhe kombëtar;

20. Të ftojme institucionet në nivel qendror dhe vendor të kontribuojnë në zbatimin e akteve ndërkombëtare për mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet kësaj rezolute, shpreh angazhimin e tij institucional për të kontribuar në përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe për të forcuar kontrollin parlamentar për zbatimin e tij, duke trajtuar me vëmendje e duhur promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë.

Vasile Hysa


RELACION

PËR

PROJEKT REZOLUTËN

“NJOHJA DHE MBËSHTETJA E VEPRIMTARISË SË MBROJTËSVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, NË PROMOVIMIN, NXITJEN DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE, FORCIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS DHE KONSOLIDIMIN E DEMOKRACISË”

I. HYRJE

Mbrojtësit e të drejtave të individëve, organizatave ose grupeve shoqërore që luftojnë për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve përbëjnë një zhvillim të rëndësishëm, në forcimin e mëtejshëm të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në konsolidimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri. Në të gjithë botën, qoftë në vende me demokraci të zhvilluar, në zhvillim ose në regjime jo demokratike, mbrojtësit e të drejtave të njerit dhe veprimtaria e tyre has në risqe, shpesh jeta dhe shëndeti i tyre është rrezikuar.

Veprimtaria e mbrojtësve në mbrojtje të të drejtave të grupeve të dobëta, veçanërisht të të drejtave të grave, minoriteteve, të huajve, azilkërkesve, të personave me orientim seksual të ndryshëm ose për shkak të identitetit gjinor të tyre (LGBTI) dhe/ose që i përkasin këtyre grupeve përballen me vështirësi dhe pengesa të mëdha nga individë, grupe të caktuara ose zyrtarë publikë. Rreziku për jetën dhe shëndetin e mbrojtësve për të drejtat e njeriut është edhe më i rritur gjatë punës së tyre për hetimin dhe denoncimin e rasteve të korrupsionit të kryer nga zyrtarët publikë dhe funksionarët shtetërore ose për denoncimin e pandëshkueshmërisë së këtyre rasteve. Sot në botë ka shumë individë që kanë sakrifikuar jetën dhe shëndetin e tyre, për hir të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe denoncimin publik të rasteve të korrupsionit kryer nga zyrtarët shtetërore dhe funksionarët publikë.

Eshtë detyrë e institucioneve dhe ligjbërësve të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi miqësor për ushtrimin e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe për promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë.

Si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, kemi bindjen se promovimi dhe mbështetja e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, është një hap i mëtejshëm në procesin e integritit evropian të Shqipërisë. Njohja dhe vlerësimi i të drejtave dhe lirive të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, përfshirë të

drejtën për liri dhe siguri, të drejtën për procesin e rregullt ligjor, lirinë e shprehjes, të drejtën e organizimit dhe të drejtën e tubimeve paqësore është e domosdoshme.

Përgjegjësisë dhe detyrime e shtetit tonë për të mbrojtur, promovuar dhe bërë efektive të drejtat e njeriut dhe liritë themelore nëpërmjet, marrjes së masave të nevojshme për konsolidimin e kushteve sociale, ekonomike dhe politike, si dhe garancitë juridike, në mënyrë që çdo individ në Republikën e Shqipërisë të mund, individualisht ose i organizuar me të tjerë, të gëzojë liritë themelore dhe të drejtat e njeriut jo vetëm dihet të njihen por edhe të përmbushen.

Kuvendi i Shqipërisë, me datë 13 Prill 2018, zhvilloi Forumin për Mbrojtësit e të Drejtave të njeriut, iniciativa e parë në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian, bazuar në iniciativën e ish Avokatit të Popullit, z. Igli Totozani. Kjo iniciativë përkoi me 20 Vjetorin e miratimit të Deklaratës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Mbrojtësin e të Drejtave të Njeriut e cila i njeh të drejtën çdo individ të mbrojë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe njeh përgjegjësinë e shteteve dhe të qeverive të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për këta individë.

Bashkimi Evropian ka ndjekur të njëjtën rrugë me miratimin e Udhëzuesit Evropian për Mbrojtjen e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut", në vitin 2004. Ky dokument propozon mënyra për të mbrojtur mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke ndjekur më tej llojet e veprimeve që mund të merren në ngjarja e një mbrojtësi të përbëjë rrezik.

Këshilli i Evropës ka përparuar në të njëjtin drejtim, me Komisionerin për të Drejtat e Njeriut duke luajtur një rol të dorës së parë. Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi "Veprimin e Këshillit të Evropës për të përmirësuar mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe për të promovuar aktivitetet e tyre" ka vanacuuar me tej pas viti 2005 deri disa ditë më parë Kur Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi Rezolutën 2225 (2018) dhe Rekomandimin 2133 (2018) *"Për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtarë të Këshillit të Europës"*.

Po ashtu, OSBE / ODIHR kontribuon ndjeshëm në krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe të sigurt për mbrojtësit e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare. Në veçanti, Udhëzuesi për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ka një rol të vlefshëm.

Njohja dhe respektimi i detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në promovimin dhe forcimin e vlerave demokratike në botë, në mbrojtjen e çdo mbrojtësi të të drejtave të njeriut, pa diskriminim dhe në mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë, nga dhuna, presionet ose represionet, kërcënimet, sulmet ose kanosjet nga çdo drejtim që vijnë, për shkak të veprimtarisë së tij/saj, në dobi të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore është objektiv me rëndësi për Kuvendin e Shqipërisë.

II. QËLLIMI DHE RËNDËSIA E PROJEKT REZOLUTËS

Qëllimi i Projekt Rezolutës është mbështetja dhe njohja e veprimtarisë së mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut, në mënyrë që të nxisin, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, forcimin e Shtetit të së Drejtës dhe konsolidimin e demokracisë.

III. VLERËSIMI I PROJEKT REZOLUTËS NË RAPORT MË AKTET KOMBËTARE E NDËRKOMBËTAR NË TË CILAT ËSHTË BAZUAR

Kjo Projekt Rezolutë u përgjigjet rëndësisë që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i jep konsolidimin e shtetit të së drejtës, demokracisë sociale dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në hartimin e saj, janë mbajtur parasysh një sërë aktesh ndërkombëtare si:

- Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut,
- Deklaratës së Kombeve të Bashkuara, datë 9 Dhjetor 1998, *“Mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve, grupeve dhe strukturave të shoqërisë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat universale të njeriut dhe liritë themelore,*
- Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut,
- Deklaratës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, datë 6 Shkurt 2008, *“Për mbrojtjen e të drejtave të mbrojtësve të të drejtave të njeriut”,*
- Rezolutat e Këshillit të Evropës 1660 (2009) dhe 1891 (2012) *“Mbi situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Evropës”* dhe Rezolutën 2095 (2016) së bashku me Rekomandimin 2085 (2016) *“Mbi forcimin e rolit dhe mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Evropës”,*
- Rezolutën 2225 (2018) dhe Rekomandimin 2133 (2018) *“Për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtarë të Këshillit të Evropës”,*
- Udhërrëfyesit të Bashkimit Europian dhe OSBE/ODHIR,
- Akte të tjera ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, (referuar si *“aktet ndërkombëtarë për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut”*);

IV. PËRMBAJTJA E PROJEKT REZOLUTËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËSË SHQIPËRISË

Pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, funksionon Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut. Sipas projekt rezolutës Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut do të shërbejë si mekanizëm për dialog midis Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të

njeriut. Nënkomisioni në konsultim me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, do të miratojë dhe do të ndjekë zbatimin e Planit të Veprimit për promovimin e mbështetjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë, bazuar në standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtarë për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut;

Nënkomisioni, brenda 6 muajve nga miratimi i kësaj Rezolute, do të paraqesë në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, raportin e detajuar mbi situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, së bashku me rekomandimet përkatëse për nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Mes kësaj Projekt Rezolute, Kuvendi merr një rol aktiv në ushtrimin e funksionit legjislativ dhe të kontrollit parlamentar duke parashikuar disa veprime:

- T'i kërkojë qeverisë dhe/ose të ndërmarrë vet nisma/t ligjore për rishikimin e legjislacionit në fushë dhe përafrimin e tij me standartet ndërkombëtare me qëllim krijimin e një mjedisi mundësues për aktivitetet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut;
- Të promovojmë nismat e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të distancohemi dhe të dënojmë çdo fushatë denigruese ose veprim kërcënues ndaj aktiviteteve të tyre;
- Të zbatojë mekanizmat e kontrollit parlamentar të parashikuara në rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë për të hetuar dhe nxjerrë konkluzione konkrete, duke propozuar dhe masat përkatëse mbi raste të denoncuar në Nënkomision nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut në lidhje me shkeljen e të drejtave të grupeve të dobëta, në veçanti: të drejtat e grave, të pjestarëve të pakicave kombëtare, komunitetit LGBTI, të drejtat e refugjatëve, emigrantëve ose popullatave në lëvizje, si dhe në lidhje me kërcënime që mund të hasin mbrojtësit e të drejtave të njeriut në luftën kundër korrupsionit kryer nga zyrtarët publikë dhe funksionarët shtetërorë ose për denoncimin e pandëshkueshmërisë së këtyre rasteve;
- Të organizojë një herë në vit, në bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet e pavarura dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri, takimin kombëtar lidhur me situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri.
- T'i kërkojë Këshillit të Ministrave, ngritjen e një strukture ndërministrorë me qëllim sigurimin e një mjedisi të sigurtë dhe të favorshëm për aktivitetin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.
- T'i kërkojë Këshillit të Ministrave të paraqesë raport vjetor në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vend. Në hartimin e raportit vjetor, të ftohen të kontribuojnë edhe autoritetet vendore dhe përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave në nivel vendor; Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe shoqëria civile të ftohen të kontribuojnë në diskutimin e raportit vjetor në një seancë të veçantë të Kuvendit të Shqipërisë;

- T'i kërkojë Këshillit të Ministrave të hartojë, në bashkëpunim dhe konsultim me shoqërinë civile, institucionet e pavarura dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri, një Strategji Kombëtare dhe Plan Veprimi Ndërministror për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut për:

- a) përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional kombëtar, në lidhje me mbrojtësit e të drejtave të njeriut, në përputhje me aktet ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të Njeriut;
- b) për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në aktet ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut;
- c) për promovimin e akteve ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut në nivel vendor dhe kombëtar;
- d) për ngritjen dhe funksionimin e një mekanizmi kombëtar për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

- T'i kërkojë strukturave përkatëse në Këshillin e Ministrave të cilat janë përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që të forcojnë bashkëpunimin me mbrojtësit e të drejtave të njeriut për denoncimin e rasteve të korrupsionit në sektorin publik.

- T'i kërkojë Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, të programojë dhe të realizojë formim të vazhdueshëm në lidhje me rolin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe forcimin e mirëqeverisjes, në përputhje me standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

- T'i kërkojë Këshillit të Ministrave të ndërmarë hapat e nevojshëm, në përputhje me aktet ndërkombëtarë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut, për të zbatuar politika lehtësuese të regjimit të vizave dhe dhënien e vizave për qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, për ata mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët, janë subjekt i ngacmimeve, kërcënimeve, sulmeve dhe/ose persekutimeve si dhe atyre që përballen me një rrezik të menjëhershëm burgimi dhe keqtrajtimi në vendet e tyre si pasojë e aktivitetit të tyre në dobi të të drejtave të njeriut. Progresi dhe masat e ndërmara nga Këshilli i Ministrave në këtë drejtim të pasqyrohen në Raportin Vjetor mbi situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

- T'i kërkojë Ministrisë për Europën dhe Punëve të Jashtme, të sigurojë një bashkëpunim të vazhdueshëm e të ngushtë me Përfaqësuesin Special të Kombeve të Bashkuara për situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe organizatat e tjera ndërkombëtare si Këshilli i Europës dhe OSBE/ODIHR, të cilat kanë për objekt të veprimtarisë së tyre, mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut;

- T'i kërkojë Këshillit të Ministrave, në mënyrë të veçantë, ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, të realizojë, në bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet e të drejtave të njeriut dhe organizatat ndërkombëtare të fushës, formimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë dhe shërbimeve të tjera, në të gjitha nivelet, lidhur me rolin dhe aktivitetin e mbrojtësve

të të drejtave të njeriut. Inkurajojmë ngritjen dhe funksionimin pranë Ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike të një zyre për të drejtat e njeriut dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut e ngarkuar të përfshijë qasje mbi të drejtat e njeriut;

- T'i kërkojë Qeverisë, në mënyrë të veçantë, ministrisë përgjegjëse për arsimin, sportin dhe rininë, në bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet e të drejtave të njeriut dhe organizatat ndërkombëtare të fushës, të marrë masat e nevojshme për përfshirjen në programet shkollore, parauniversitare të informacionit për rolin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, si dhe për përgatitjen dhe formimin profesional të mësuesve, në këtë fushë sipas modeleve më të mira;

Duke vlerësuar rëndësinë sistemit të drejtësisë dhe aksesin në drejtësi të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, Kuvendi fton organin e prokurorisë dhe sistemin gjyqësor të kontribuojnë, në mënyrë që mbrojtësit e të drejtave të njeriut, të gëzojnë akses në sistemin e drejtësisë dhe të mundësohen hetime të shpejta dhe të plota për rastet e dhunës, kërcënimeve dhe/ose ngacmimeve ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut;

Një rol të rëndësishëm në promovimin e punës dhe aktivitetit të mbrojtësve të të drejtave të njeriut luan edhe media. në projekt rezolutë theksohet se ftohet media e pavarur, publike dhe jopublike, për të kontribuar, në krijimin e hapsirave për të promovuar punën dhe aktivitetin e mbrojtësve të të drejtave, në dobi të forcimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë.

Së fundi nga radha, por jo nga rëndësi është roli i institucioneve të pavaruara, kushtetuese dhe të krijuar me ligj për promovimin dhe mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, sidomos Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ato ftohen të bashkëpunojnë mes tyre si dhe ftohen të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor të kontribuojnë në zbatimin e akteve ndërkombëtare për mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Në kuadër të mekanizmit ndërinstitucional të ngritur me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 49/2017.

Të gjithë institucionet në nivel qendror dhe vendor mund dhe duhet të bashkëpunojnë me organizatat/rrejetet e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare të fushës për të promovuar dhe mbrojtur mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe aktivitetin e tyre, në nivel vendor dhe kombëtar.

Vander Nys
NL